

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 83, datë 29.07.2024

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË NËNTËMBËDHJETË TË 14 SUBJEKTEVE PËRFITUESE, TË CILËT DO TË PËRFITOJNË MASËN E GRANTIT TË RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA TËRMETI I DATËS 26 NËNTOR 2019, SIPAS PROJEKTIT MODEL

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” miratuar me Ligjin nr.97/2019, VKM nr. 5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, VKM nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të procesit të rindërtimit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.8, datë 28.01.2021 “Për miratimin e kontratës model për kalimin e masës së grantit të rindërtimit për banesat individuale të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019 sipas projekteve model nga Bashkia Durrës tek përfituesi” dhe sipas relacionit të hartuar nga Komisioni i Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit, në Bashkinë Durrës, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I :

1. Miratimin e listës së nëntëmbëdhjetë të 14 subjekteve përfituese, të cilët do të përfitojnë masën e grantit të rindërtimit të banesave individuale të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, sipas projektit model, pasqyruar në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi si pjesë përbërëse e

tij, hartuar nga Komisioni i Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 30.07.2024



ANEKSI 1. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA MASA E GRANTIT TË RINDËRTIMIT

NR	NJESIA ADMINISTRATIVE	EMRI	ATESIA	MBIEMRI	PËRBËRJA FAMILJARE	STRUKTURA E BANESËS	VLERA E GRANTIT
1	R2	GAZMEND	ABDYL	KUQI	7	3+1	3,428,958
2	R2	ADRIAN	ALI	CANGONJA	2	1+1	2,236,552
3	R2	RIZA	DALIP	SHULI	4	2+1	2,617,558
4	R5	DASHNOR	SELMAN	ZEQIRI	2	1+1	2,236,552
5	R5	LUAN	ISUF	KAPLLLANAJ	5	3+1	3,428,958
6	R5	ISUF	LUTFI	KAPLLLANAJ	7	3+1	3,428,958
7	R5	FATMIR	FLAMUR	KAPLLLANAJ	5	3+1	3,428,958
8	R5	ARBEN	RIZA	XHAFAJ	6	3+1	3,428,958
9	R5	FAIS	AHMET	ISAKU	4	2+1	2,617,558
10	R5	ARBEN	MUNIR	ISAKU	4	2+1	2,617,558
11	R5	VERI	DERVISH	TILA	4	2+1	2,617,558
12	KATUND I RI	PAL	GEJE	LLYCI	2	1+1	2,236,552
13	MANEZ	ALMA	REXHEP	HUQI	5	3+1	3,428,958
14	ISHEM	GJERGJI	LUK	ÇERRI	8	3+1	3,428,958

Shënim

Age Llyci është trashëgimtarja ligjore i Pal Llycit.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës


Nr. 446 prot.
13

Durrës, më 01 8 .2024

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës nr.83 datë 29.07.2024 “Për miratimin e listës së nëntëmbëdhjetë të 14 subjekteve përfituese, të cilët do të përfitojnë masën e grantit të rindërtimit të banesave individuale të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, sipas projektit model”.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.
Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI
EMILJAN JANI

